



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:052353  
Datë: 13.05.2024  
Numri i dokumentit: 05677650

KP.nr.147/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të paditësit F.A. me adresë në Lagjen Kalabria, Blloku A1, Lokali 86, kundër të paditurit "VISAMETRIC" L.L.C, me numër unik identifikues 811887655, me seli në rrugën "Kaçaniku" nr. 25, lagja e Muhaxherëve, Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Urim Vokshi dhe Naim Spahiu me seli në Prishtinë, me objekt kontesti shkelja e të drejtave të konsumatorit, me datën 13.05.2024, merr këtë :

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit F.A. e iniciuar në emër të interesit kolektivë e ushtruar më datën 09.12.2022, kundër të paditurit "VISAMETRIC" L.L.C, me numër unik identifikues 811887655, për shkak të shkeljes së të drejtave të konsumatorit.

A r s y e t i m

Paditësi, më datën 09.12.2022, ka parashtruar padi kundër të paditurit të "VISAMETRIC" L.L.C, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar të konstatohet shkelja e të drejtave të konsumatorit, si dhe të detyroj të paditurën që të ndalë veprime me të cilën detyrohen aplikantët të paguajnë postën dhe të u mundësoj aplikantëve pranimin e pasaportës në zyrët e të paditurës .

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 07.05.2024, nuk ka prezantuar paditësi, për të cilin Gjykata ka dëshmi se i njëjti ishte i ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa mungesën për në seancë nuk e ka arsyetuar, i autorizuari i të paditurit ka propozuar që konform nenit 423par.3 të LPK-së padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr.

Meqenëse paditësi nuk ka prezantuar në seancën e shqyrtimit kryesor, mungesën e tij nuk e ka arsyetuar edhe pse i njëjti ishte i ftuar në mënyrë të rregullt, fakt ky i vërtetuar nga procesverbali i seancës së datës 29.04.2024, në të cilën seancë ka prezantuar i autorizuari i paditësit, dhe sipas propozimit të autorizuarit të paditurit, pasi që janë plotësuar kushtet ligjore, gjykata vendosi që të njëjtën ta konsideroj të tërhequr në kuptim të nenit 423 par.3 të LPK-së

Nga të lartcekurat Gjkata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi konform nenit 409 par.1 të LPK-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.147/22 me datë 13.05.2024

Gjyqtari  
Gent Bekeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.